

VENDIM
Nr. 36/2017

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN DHE VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË LEGJSLACIONIT NË FUQI, MBROJTJEN E INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, NEGOCIMIT TË MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10 116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ A.S.-SË”, SI EDHE EVIDENTIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2016

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, dhe të nenit 22, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negocimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.-së”, si edhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raporti Përfundimtar i komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negocimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.-së”, si edhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje” i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 6.4.2017